




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes , prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtimes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Për kontratën "Furnizim me paisje për IT" ishte përdorur procedura e negociuar me arsyetimin si blerje emergjente në kundërshtim me opinionin e KRPP-së.
- B1 Gjatë ekzaminimit të tenderëve për pesë aktivitete të prokurimit për punë autoriteti kontraktues nuk i kishte ngarkuar projektet ekzekutive në platformën e-prokurimi.
- A2 Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve.
- A3 Komuna nuk kishte arritur të bëjë verifikimin e 20% të pronave për qëllime tatimore siç kërkohet me ligj.
- B2 Komuna nuk kishte përgaditur Planin Vjetor për mbështetje financiare të Organizatave Jo Qeveritare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtimes .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtimes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtimes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtimes .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: moszbatim i procedurave të duhura të prokurimit, menaxhimit e të arkëtueshmeve, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe dobësitë në menaxhimit e pasurive përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimit e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja dhe gjashtë (6) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Procedurat e prokurimit për furnizim me pajisje të IT nuk ishte në pajtueshmëri me rregullat e prokurimit publik

Gjetja Sipas nenit 48.2 të rregullës së prokurimit publik nr.001/2022 për raste të emergjencës ekstreme- ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës. Kushtet dhe rrethanat për përdorimin e procedurave emergjente janë domosdoshmëria strikte e zhvillimit të një aktiviteti prokurimi në baza emergjente, motivuar nga ngjarje të verifikueshme në mënyrë objektive që nuk ishin të parashikueshme nga autoriteti kontraktues, rrethanat emergjente nuk i atribuohen veprimeve neglizhente apo qëllimshme ose mosveprimeve të autoritetit kontraktues.

Komuna kishte dërguar në KRPP njoftimin për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. KRPP kishte dhënë opinionin se “Aktiviteti i prokurimit nuk është në pajtim me rrethanat e përshkruara si emergjenca ekstreme, gjegjësisht nuk është në pajtim me nenin 48.2 të Rregullorës për Prokurimin Publik”. KRPP ka rekomanduar autoritetin kontraktues të analizojë dhe adresojë të gjithë faktorët që kanë sjell deri te përdorimi i kësaj procedure, po ashtu të vlerësojë të gjitha mundësitë që këtë aktivitet ta zhvillojë me procedurë të hapur e cila do të rriste transparencën, konkurrencën dhe trajtimin e barabartë për të gjitha palët e interesuara.

Procedurat për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje për IT” ishin zhvilluar përmes procedurës së negociuar me arsyetimin si blerje emergjente.

Autoriteti kontraktues nuk kishte marrë për bazë opinionin e KRPP-së por kishte vazhduar aktivitetin e prokurimit përmes procedurës së negociuar e cila kishte rezultuar me nënshkrimin e kontratës me operatorin ekonomik me vlerë 15,288€.

Ndikimi Kjo mund të ndikoj në zvoglimin e transparencës, konkurrencës dhe trajtimin jo të barabartë të të gjitha palëve të interesuara.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë masat e nevojshme në mënyrë që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas kërkesave të rregullës përkatëse të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos publikimi i projektit ekzekutiv në tenderët për punë

Gjetja Neni 28.10 i LPP kërkon: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Gjatë ekzaminimit të tenderëve "Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes", "Asfaltimi i rruges Godanc -Zborc", dhe "Rregullimi i parkut-Sheshit në Qytetin e Shtimës (faza IV)", "Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumi i parë në Kosovë" dhe "Rregullimi i disa segmenteve të rrugëve dhe rrjetit të kanalizimit në Shtime" autoriteti kontraktues i kishte përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishte bashkëngjitur në platformen e-prokurimi projektin ekzekutiv përkatës. Sipas zyrtarëve të komunës, projektin ekzekutiv të tenderit përkatës Operatorët Ekonomik (OE) që ishin të interesuar për ato tenderë e kishin marrë fizikisht në zyrat e komunës.

Kjo sipas zyrtarëve të komunës, kishte ndodhur për shkak të mos përkrahjes teknike e platformes e-prokurimi shkak i hapësirës së pamjaftueshme për të ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.

Ndikimi Mungesa e projektit ekzekutiv në platformen e-prokurimit mund të ndikojë që punët e planifikuara të mos zhvillohen sipas kriterëve dhe standardeve të parapara, rrjedhimisht edhe në zbatim të planit dinamik të punëve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo procedurë tenderuese për punë, përveç përgatitjes së projektit ekzekutiv të bëjë publikimin e tij së bashku me dokumentacionin tjetër për atë tender.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve**

Gjetja Sipas nenit 20 të Rregullores së brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë ndër të tjera: numrin identifikues të fermerit, projektin financiar, fletë posedimin për patundshmëri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë, konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit. Poashtu, sipas nenit 20 të rregullores së MF-së nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake kërkohet të sjellin dëshminë se kanë kryer të gjitha obligimet.

Ne kemi identifikuar se:

- Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi për furnizim me serra në sipërfaqe prej 50m2 nuk ishte në pajtueshmëri

me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës, sepse mungonin kërkesat e përcaktuara me rregullore si në vijim: projekti financiarë dhe fletëposedimi për patundshmëri.

- Për subvencionin me vlerë 3,000€ për klubin e hendbollit për femra ne kemi identifikuar se në dosje i mungonin dëshmitë se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirëfilltë të kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes së thirrjeve publike dhe vlerësimit të dosjeve të aplikuesëve për subvencione.

Ndikimi

Mos harmonizimi i kërkesave të thirrjeve publike për subvencionimin e fermerëve në fushën e bujqësisë dhe sportit në pajtim me rregulloret përkatëse ndikon në menaxhimin jo të drejtë dhe efikas të mjeteve të ndara për subvencione.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos arritja e verifikimit (inspektimi) 20% pronave të paluajtshme

Gjetja

Bazuar në ligjin nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, respektivisht neni 15.2 përcakton se: Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Komuna gjatë vitit 2022 nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin (inspektimin) e 20% të pronave të paluajtshme sipas kërkesave të ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme në fuqi. Ne kemi vërejtur se komuna ka bërë disa modifikime në sistemin e tatimit pronë, por nuk ka qenë në gjendje të na ofron dëshmi (formularët) të verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme. Gjatë këtij viti komuna kishte kryer verifikimin e vetëm 915 prej 10,850 objekteve sa janë në tërësi në territorin e Komunës apo 8.4%.

Komuna ka pasur mungesë të anketuesëve në terren për verifikim (inspektim) të pronave, si dhe problemeve të vazhdueshme teknike me paisjen GPS.

Ndikimi

Mos verifikimi i 20% të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen. Tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave të komunës, prandaj duhet të trajtohet me kujdes plani i inkasimit, sepse ka ndikim direkt edhe në realizimin e projekteve kapitale dhe financimeve tjera të parashikuara nga ky burim.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Duhet të bëhet verifikimi (inspektimi) i pronave komunale siç parashihet me ligj në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve**

Gjetja Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.

Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës kishte paraparë që gjatë vitit 2022 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, megjithatë nuk kishte përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Mos marrja e masave të nevojshme për rritjen e llogaridhënies për menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve, ishte shkak për mos përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Ndikimi Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave se cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe e objektivave se për çfarë janë të parapara këto mjete, kohen e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që komuna të përgatitë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ-ve dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe të siguroj se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren për mbështetje financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2022 ishte 1,122,783€, prej tyre ishin shpenzuar 987,545€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyre, furnizime mjekësore, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime për udhëtime zyrtare, blerja e pajisjeve, etj.

Çështja A4 - Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblerjes

Gjetja Neni 22 i rregullës financiare nr.01/2013 Shpenzimi i parave publike, - procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.

Në dy (2) pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 20,685€, kemi identifikuar se paraprakisht është pranuar fatura pastaj është krijuar urdhërblerja.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhër blerjes, mund të rezultojë me shërbime apo furnizime pa kërkesë nga njësia përkatëse, të cilat njëkohësisht mund të jenë jo të përshtatshme në kohë si dhe mund të ndikojnë në vonesa në pagesën e faturave.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 9,870€ pasi që shërbimet e varrimit ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa ishte dashur që pagesa të bëhet nga kategoria e subvencioneve.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo

adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 53,668,954€, pasurive jokapitale është 504,438€, si dhe e stoqeve 48,568€.

Çështja A5 - Mangësi në regjistrat e pasurive

Gjetja

Rregullorja nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare, neni 2 - Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Ndërsa neni 6 - regjistri i pasurive jo financiare, paragrafi 3. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga procedurat tona substanciale të auditimit kemi vërejtur se pasuritë në PVF ishin mbivlerësuar në vlerë prej 123,540€, kjo për arsye se:

- Regjistri i pasurisë nuk ishte i saktë pasi që 66 pasuri kapitale me vlerë neto prej 142,401€, ishin regjistruar si jokapitale (nën 1,000€), prej tyre 20 pasuri ishin regjistruar dyfish edhe si kapitale edhe si jokapitale. Kjo kishte ndikuar në mbivlerësimin e pasurive jokapitale në PVF për këtë vlerë.
- Regjistri i pasurisë kapitale (mbi 1000€) është nënvlerësuar në vlerë neto prej 43,253€ shumë kjo e cila përfshinë 47 pasuri të ndryshme si: Laptop, kompjuter, makina autolarëse, gjenerator etj dhe pagesën për mirëmbajtje investive "Rregullimi i hapsirave tek Shtëpia e Kulturës, Palestra e qytetit dhe Muzeu Shtime".
- Regjistri i pasurisë kapitale poashtu ishte mbivlerësuar me një vlerë prej 24,392€, pasi që në regjister ishin përfshirë tri (3) vetura me vlerë 9,689€ të cilat sipas normës së zhvlerësimit do duhej ta kishin vlerën neto në libra zero (0), si dhe gjashtë (6) vetura të cilat figuronin në regjister me vlerë 14,703€ të cilat komuna i kishte shitur dhe ende nuk ishin larguar nga regjistri i pasurive.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur dhe kontrolleve joefikase në azhurnimin dhe mirmbajtjen e regjistrave të pasurisë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale.

Ndikimi

Regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ në llogarinë e pasurisë jokapitale ka mbivlerësuar këtë të fundit ndërsa mosregjistrimi i 47 aseteve dhe mbajtja e veturave në regjistra me vlerë fillestare ka nën/mbivlerësuar llogarinë e pasurisë kapitale.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj se me rastin e gjenerimit të raporteve të e-pasurisë të shtohet kujdesi dhe të funksionoj kontrollin në regjistrimin përkatësisht largimin me kohë të pasurive kapitale në mënyrë që pasuria e prezantuar në PVF të jetë e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 755,644€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë (753,657€) dhe qiraja (1,987€).

Çështja B4 - Efikasiteti i ulët në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme.

Gjetja

Sipas Rregullores së Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Sipas regjistrave, vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2022 ishte 755,644€. Rritja në krahasim me vitin 2021 ishte 51,989€ ose 7.4%.

Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë (parcela), i cili është rritur për 53,325€ ose 30% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Nga borxhet e tatimit në pronë, 57,584€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH).

Nga testimi i mostrave tek shfrytëzimi i pronës publike, kemi identifikuar mungesë të dokumentacionit si: aktvendimet për ngarkesën (faturat), kartelat analitike të klientëve që dëshmojnë të drejtën për arkëtim. Vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme për këtë kategori është 1,987€ dhe nuk janë bërë përpjekje për arkëtimin e tyre.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në marrjen masave për arkëtim, si dhe në ruajtjen e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme të shfrytëzimit të pronës publike.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me efekt negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Ndërsa mungesa e dokumentacionit për kategorinë shfrytëzimi i pronës publike pamundëson ofrimin e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme dhe marrjen e masave për arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës ruajnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritë e arkëtueshme të shfrytëzimit të pronës publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë për Ndërmarrjet Shoqërore.

Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronë, neni 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.

Komuna e Shtimes për vitin 2022 kishte raportuar llogari të arkëtueshme

nga tatimi në prona prej 753,657€, ku një pjesë e borxheve të tatimit në pronë prej 57,584€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh). Këto llogari të arkëtueshme janë bërë barrë aktuale vjetore e faturës së tatimit në pronë të cilat po rriten vit pas viti, dhe gjasat për inkasim të detyrueshëm mund të jenë të vogla. Sipas kontratës me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) blerësi i ri i pronës shoqërore ka obligim të paguaj tatimin në pronë vetëm për 12 muaj kalendarik, kurse pjesa tjetër e borxhit paguhet gjatë procesit të likuidimit. Gjatë vitit 2022 komuna e Shtimes nuk kishte komunikuar me AKP-në si dhe deri në kohën e auditimit zgjidhja nuk është arritur.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të zyrtarëve për mos lejimin e shpenzimeve të parasë publike për këtë qëllim.

Ndikimi	Trendi i rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të borxheve të komunës.
Rekomandimi B5	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet e NSh-ve të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente të raportuara në PFV në fund të vitit 2022, ishte 883,147€.

Çështja A6 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente.

Gjetja Sipas Nenit 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore: “Organizatave buxhetore në harmoni me LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente”.

Vlera e detyrimeve kontigjente, e shpalosur në PVF të vitit 2022 ishte 883,147€, ndërsa në bazë të analizës tonë të listës së detyrimeve kontigjente vlera e cila ishte dashur të prezantohej është 801,304€. Prandaj mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në PVF ishte për 81,843€. Dallimi është për arsye se komuna kishte prezantuar detyrime kontigjente edhe pse pagesa iu ishte bërë palëve.

Shkak i shpalosjes jo të saktë të detyrimeve kontigjente ishte mos funksionimi i kontroleve të brendshme në përditësimin e regjistrit të kontingjencave për rastet që janë kryer pagesat sipas vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Dobësitë e identifikuar në shpalosjet e detyrimeve kontigjente ndikojnë në prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV. Kjo mund të ketë ndikim negativ në vendimmarrjen e menaxhmentit dhe tregon jo transparencë ndaj palëve të interesit.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontigjente në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon vetëm me Drejtorin e auditimit. NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës ku ishin planifikuar dhe realizuar gjashtë (6) auditime. Përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2022. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, subvencioneve si dhe në fushën e të hyrave. Komiteti i auditimit ishte funksional gjatë vitit 2021 dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku kishte diskutuar raportet e auditimit të brendshëm si dhe atë të zyrës kombëtare të auditimit.

Çështja B6 - Mos kompletimi i NJAB-së

Gjetja	Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7,000,000 duhet të ketë së paku tre auditorë Komuna ka të themeluar NJAB i cili përbëhet vetëm nga Drejtori i auditimit. Sipas rregullores komuna i plotëson kriteret që njësia të ketë në total tre (3) auditorë. Kjo ka ndodhur për shkak nuk kishte shpallur konkurs për plotësimin e këtyre pozitave.
Ndikimi	Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet të sigurojë buxhetimin dhe plotësimin me staf të mjaftueshëm të NjAB-së për të ndikuar në forcimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	7,704,029	8,698,761	7,702,313	7,172,793	7,820,655
Grante Qeveritare - Buxheti	7,169,720	7,175,336	6,582,714	6,530,067	7,093,061
Financimi përmes huamarrjes	0	68,484	68,484	15,098	45,045
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	602,055	308,363	56,810	255,124
Të bartura nga viti i kaluar	0	307,385	261,935	161,366	120,349
Të hyrat vetanake	534,309	534,309	470,826	402,960	306,158
Donacionet vendore	0	11,067	9,864	6,493	918
Donacionet e jashtme	0	125	125	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 994,732€. Rritja ishte nga: të hyrat vetanake të bartura në vlerë 307,385€, financim nga huamarrja në vlerë 68,484€, financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve 602,055€ nga donacionet në vlerë 11,192€ dhe rritje të buxhetit final në krahasim me buxhetin fillestar nga granti qeveritar në vlerë 5,616€.

Në vitin 2022 komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit përfundimtar, me një realizim më të lartë rreth 5% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	7,704,029	8,698,761	7,702,313	7,172,793	7,820,655
Pagat dhe mëditjet	4,405,585	4,490,637	4,308,370	4,337,631	4,274,089
Mallrat dhe shërbimet	1,000,704	1,122,783	987,545	847,662	963,803
Komunalitë	210,000	210,000	202,234	156,468	197,717
Subvencionet dhe transferet	150,000	191,500	182,839	155,917	267,401
Investimet Kapitale	1,851,210	2,683,842	2,021,325	1,675,116	2,117,646
Rezervat	86,530	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve në buxhetin final ishte 4,490,637€, kishte rritje për 85,052€ apo 13% krahasuar me buxhetin fillestar me vendim të qeverisë për harmonizimin e pagave dhe kishte një realizim prej rreth 96%.

- Kategoria mallra dhe shërbime në buxhetin final ishte 1,122,783€, kishte rritje buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 122,079€, rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake nga vitet paraprake në vlerë 121,628€, dhe 451€ nga donacionet. Deri në fund të vitit, buxheti për këtë kategori ishte realizuar rreth 88%.


- Kategoria e komunalive nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit, ndërsa buxheti i realizuar ishte 202,234€ apo rreth 96%.

- Kategoria subvencioneve dhe transfereve në buxhetin final ishte 191,500€, kishte rritje të buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 41,500€ dhe ishte realizuar rreth 95%. Rritja e buxhetit në vlerë 41,500€ ishte nga bartja e të hyrave vetjake nga vitet paraprake.

- Kategoria investime kapitale në buxhetin final ishte 2,683,842€, kishte rritje të buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar për 832,632€. Nga kjo vlerë, 86,530€ fillimisht ishin buxhetuar si rezerva dhe pastaj ishin rregulluar duke i buxhetuar për projekte kapitale, pastaj 144,026€ ishin nga bartja e të hyrave vetjake nga vitet paraprake, si dhe vlera prej 602,055€ është klauzola për kredinë për "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza - Shtime" si dhe vlera prej 21€ është nga donacioni. Deri në fund të vitit buxheti për këtë kategori ishte realizuar rreth 75%.

Realizimi i ulët i buxhetit është si pasojë e vonesave në realizimin e projekteve, ku kryesisht projekti "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza - Shtime" financim nga huamarrja, për vitin 2022 ishte buxhetuar 602,055€, ndërsa realizimi ishte në vlerë 308,363€ apo 51.22%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara në vitin 2022 ishin në vlerë 639,670€ apo rreth 20% më shumë se planifikimi. Arsyeja për këtë rritje është për shkak të rritjes së të hyrave jo tatimore në krahasim me planifikimin në vlerë prej 145,875€ apo 168%. Kjo për arsye të rritjes së të hyrave nga gjobat nga Policia e Kosovës dhe të hyrat nga taksat për certifikata dhe dokumente të tjera.

Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për lejet e ndërtimit, taksat për certifikata të ndryshme, të hyrat nga regjistrimi automjeteve, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës, taksa për regjistrim të trashëgimisë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale, të hyrat tjera administrative, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	534,309	534,309	639,670	523,133	338,196
Të hyrat tatimore	319,176	319,176	278,662	242,640	147,609
Të hyrat jo tatimore	215,133	215,133	361,008	280,493	190,587

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Komunës së Shtimes ka rezultuar me 15 rekomandime kryesore. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, gjashtë (6) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo procedurë tenderuese për punë, përveç përgatitjes së projektit ekzekutiv të bëjë publikimin e tij së bashku me dokumentacionin tjetër për atë tender. Dhe kurdo që ndonjë OE merr fizikisht ndonjë dokument shtesë, të mbahet regjistër i dorëzimit pranimit të atyre dokumenteve.	Edhe në vitin 2022 ishin përsëritur rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që komuna të përgatitë planin vjetor për mbështetje financiare për OJQ-ve dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren për mbështetje financiare.	Nuk janë marrë veprime për përpilimin e planit për mbështetje financiare.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave ndaj operatorëve ekonomik.	Komuna kishte marr masa dhe kishte zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar të jetë meritör, në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara në mënyrë cilësore.	Janë marrë veprime për implementimin e rekomandimit.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë kontrollet e brendshme lidhur me procesin e hartimit të specifikave, të përcaktimit të procedurave dhe llojit të kontratave, vlerësimit të ofertave dhe të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të arrijë qëllimet e planifikuara.	Në procedurat e këtij viti nuk kemi hasur në gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
6.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PFV-ve, në mënyrë që PFV-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruhet vetëm pasi që janë siguruar se PFV-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.	Komuna kishte ndërmarr masa dhe kishte zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
7.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme në identifikimin e të gjithë tatimpaguesve të tatimit në pronë, që kanë përfituar dy herë zbritjen e lejuar për njësinë e banimit parësor, dhe t' i korrigjoi statutin e pronës së dytë dhe të tretë të njëjtë pronar si vendbanim dytësor.	Komuna kishte ndërmarr masa dhe e kishte zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
8.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, deri në bartjen përfundimtare të buxhetit tek MPB, duhet të kërkojë nga menaxhmenti i AME-së, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës, të sigurohen së paku kontratat e punës dhe konfirmimin që ata zyrtar kanë punuar gjatë muajit përkatës, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët që kanë përmbushë detyrimet nga marrëdhënia e punës.	Pagesat janë bërë në pajtueshmëri me kontratat.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrolleve në këtë fushë, që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Nuk janë ndërmarrë veprime për pagesa sipas klasifikimit të kodeve përkatëse.	Nuk ka filluar zbatimi

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave të prokurimit ka analizuar dhe ka zgjidhur të gjitha pengesat e mundshme. Në anën tjetër, të sigurojë se punët kryhen sipas afateve të përcaktuara në kontratë dhe pa vonesa, në mënyrë që të shmangen shpenzimet eventuale shtesë si dhe ndikimet tjera buxhetore. Derisa për diferencën e paguar përtej punëve të kryera, ta trajtoj me OE në mënyrë që mjetet shtesë t'i kthej në buxhetin e komunës.	Komuna kishte ndërmarr masa dhe kishte adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korrigjimin dhe menaxhimin e regjistrit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me statutin "Investime në vijim" dhe nëse jeta e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuara me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë.	Komuna kishte marr masa dhe kishte zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, dhe të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat e konstatuara. Po ashtu raporti i përgjithshëm i inventarizimit të kryhet deri në datën e përcaktuar me vendimin për themelimin e komisioneve, dhe të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat identifikohen gjatë inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.	Komuna kishte marr masa dhe kishte zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet e NSh-ve të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara.	Komuna nuk kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se mbledhja e LI.A bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore duke i zvogëluar LI.A dhe rritjen e të hyrave të komunës.	Komuna nuk kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatim
15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë buxhetimin dhe plotësimin me staf të mjaftueshëm të NjAB-së për të ndikuar në forcimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë.	Nuk janë marrë veprime për kompletimin e NJAB-së.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Ernes Beka, Udhëheqës i ekipit



Bahri Statovci, Anëtar i ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit/Sektori i Financave

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Qemajl Aliu



Kryetari Komuna së Shtimes

Data: 26 qershor 2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.